



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo



KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY

Anëtarit të Komitetit për Politikë dhe Financa
Z/znj _____

Në bazë të dispozitave të nenit 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale si dhe në bazë të dispozitave të nenit 41 të Statutit të Komunës së Novobërdës.

F T O J

Mbledhjen e dytë të Komitetit për Politikë dhe Financa e cila do të mbahet më 16.02.2021 (e martë) duke filluar ne ora 10:00.

R e n d i i d i t ë s

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF-se;
2. Raport mbi dëmet e shkaktuara nga vërshimet gjatë muajit janar 2021 (komisioni për vlerësimin e dëmeve);
3. Aktivitetet rreth luftimit të pandemisë Covid 19;
4. Raport nga OJQ, përfituese të mjeteve për ndihmë qytetarëve, për shkak të pandemisë Covid 19;
5. Raporti i komisionit për të gjeturat e Auditorëve të jashtëm për vitin 2019;
6. Raporti i Kryetarit për vitin 2020;
7. Shqyrtimi i rregullores për mbikqyrje të pasurisë jofinanciare;
8. Të ndryshme.

Mbledhja do të mbahet në hapësirat e K.K-së në Novobërdë.

Më:08.02.2021
Në: Novobërdë



Kryesues i Kuvendit
Nebojsa Arsic

Nebojsa Arsic



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosova

Komuna e Novobërdës

Opština Novo Brdo–Municipality of Novo Brdo

KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e parë e Komitetit për Politikë dhe Financa e mbajtur më 22.01.2021, duke filluar në orën 10:00. Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesusi i Kuvendit Nebojsa Arsic, Anëtarët e KPF-së: Mirjana Simijonovic, Milica Jovanovic, Xhejlane Behluli, Selatin Nuhiu, Drejtori i Administrates Driton Abdyli dhe përfaqësuesi i OSBE-së.

Kryesuesi pasi përshëndeti të pranishmit tha: Para se të fillojmë me rendin e ditës duhet konstatuar kuorumin prezentë janë të gjithë antarët e KPF-së pas kësaj e hapi mbledhjen me këtë:

R e n d d i t e

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF-se;
2. Raporti i Kryesuesit për punën e Kuvendit për vitin kalendarik 2020;
3. Informim nga Drejtoria e Arsimit për përfundimin e gjysëmvetorit të parë;
4. Propozimi i orarit të mbajtjes së mbledhjeve të KPF-ës për vitin 2021;
5. Propozimi i orarit të mbajtjes së mbledhjeve të KK për vitin 2020;
6. Të ndryshme.

Kryesusi tha: a keni ndonjë propozim apo pajtoheni me këtë rend dite?

Driton Abdyli Drejtor i Administrates pasi pershendeti të pranishmit tha: kerkoj që edhe këtë propozimin tim ta fusni në rend dite, kjo pikë ka qenë edhe dy herë më herët por nuk është votuar po kerkoj përseri që të futet në rend dite dhe të shkoj në Kuvend propozimi për shitjen e automjeteve të pashfrytëzuara të zhvlersuara të Komunës në ankand publik.

Pasi nuk pati propozime tjera Kryesusi e hudhi ne votim rendin e ditës me këtë pikë shtesë të propozuar nga Drejtori i Administrates.

Aprovohet njëzëri rendi i ditës nga antarët prezent të KPF-së me këtë pikë shtesë të propozuar;

1. Pruarja e vendimit për shitjen e atomjeteve të vjetëra dhe të zhvlersuara të Komunës së Novobërdës;

Pika e parë: Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF-se;

Kryesuesi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Pasi nuk pati vërejtje procesverbali aprovohet njëzëri nga antarët e KPF-së.

Pika e dytë: Raporti i Kryesuesit për punën e Kuvendit për vitin kalendarik për vitin 2020;

Kryesuesi tha: me material e keni marr raportin e punes se Kuvendit për vitin 2020, e dini se vitin e kaluar e kemi pasur me specifik për arsye të pandemisë me covid 19, edhe ne si Kuvend kemi punuar me rrethana me të vështira dhe në muajt kur ka qenë vala e pandemis nuk kemi mbajtur as mbledhje, mirëpo kemi pasur më pastaj dy mbledhje të jashtzakonshme, më konkretisht do ta prezantoj raportin në mbledhje të Kuvendit para të gjithë antarëve, nese keni ndonjë pyetje ose propozim urdhëroni, ju faleminderit.

Pasi nuk pati diskutime aporovohet njëzëri kjo pikë që të shkoj në Kuvend.

Pika e tretë: Informim nga Drejtoria e Arsimit për përfundimin e gjysëmvetorit të parë;

Kryesuesi tha: atë raport nuk e kemi marr as me shkrim dhe nuk është askush që të raportoj nga Drejtoria e Arsimit nuk kemi çka të diskutojmë e as ta dergojm në Kuvend.

Selatin Nuhiu pasi pershendeti të pranishmit tha: mendoj se më shumë se kurr është duhur me qenë Drejtoria e Arsimit këtu pasi që shkollat në Komunën tonë por edhe në të gjitha Komunat kanë pas vështersi, ka pasur mësimdhënës dhe nxënës me covid, është duhur të jenë shumë serioz me kërkesën tonë për me ardh me raport në mënyrë që të informohemi se çka ka ndodhë, kemi ndar edhe buxhet shtesë por këta si çdo herë janë të papergjegjshëm, mundemi ta votojm ta dergojm në Kuvend por nese nuk na vjen raporti dhe nuk vjen askush atëher nuk po jemi serioz.

Xhejlane Behluli pasi pershendeti të pranishmit tha: mendoj pasi që është vetem informim të votohet që të shkoj në Kuvend.

Milica Jovanovic tha: unë pajtohem pasi që sa herë ka pasur që të bin ndonjë raport ne e kemi votuar që të shkoj në Kuvend por po duket që nuk janë serioz, qështja tjetër është se vet zyrtari ka premtuar që në janar do ta bie këtë raport.

Selatin Nuhiu tha: unë mendoj për këtë raport të vij Drejtoria e Arsimit dhe për çdo mbledhje të raportoj së bashku me shtabin emergjent.

Milica Jovanovic tha: nese planifikojm me ardh në Kuvend atëher të ja bashkangjesin edhe raportin e punes këtij raporti.

Kryesusi tha: kjo nuk duhet që të shkoj në Kuvend, mirëpo nese Drejtoria e Arsimit ndërkohë e sjell raportin atëher ne do ta fusim si propozim shtesë në rend dite dhe do tju dergojm materialin.

Pika e katërt: Propozimi i orarit të mbajtjes së mbledhjeve të KPF-ës për vitin 2021;

Kryesusi tha: me material e keni marr orarin për mbajtje të mbledhjeve e keni shikuar si dhe tash keni mundësin që ta shikoni, nese keni ndonje propozim/ndryshim urdhëroni.

Përfaqësuesi i OSBE-së Edmond Hyseni pasi pershendeti të pranishmit tha: përveç orarit është mirë që ta pregadisni edhe planin e punës së Kuvendit Komunal ku përfshin pikat për çdo muaj si Janar, shkurt e kështu me radhë, është mirë më pas këtë planë pasi që ka mundësi e kërkojm edhe prej nivelit qendror.

Xhejlane Behluli tha: po nderlidhem me këto data pasi që veq kemi bërë një planifikim për gjithë vitin por Kuvendi shpërbëhet në shtator, andaj deri në shtator të bëhet planifikimi.

Selatin Nuhiu tha: pajtohem plotësisht me përfaqësuesin e OSBE-së por ky propozim është duhur që të bëhet 2-3 vite më herët, ne e dim që obligative është me ardh raporti financiar i tremujorit të parë, raporti gjashtëmujorë, raporti vjetor financiar, raporti i auditorit si dhe pikat obligative prej Kryetarit të Komunës, si raporti gjashtëmujorë por këto pika nuk na kanë ardh në Kuvend dhe nuk e di a i keni ngrit ju këto qështje.

Edmond Hyseni tha: unë vetem ju tregova se duhet të bëhet edhe plani i punës dhe ekzekutivi duhet të njoftohet kur ka pika në Kuvend. Ka shumë puntori që ka organizuar OSBE-ja për të gjitha ato që u permenden por pjesëmarrja e Komunës suaj ka qenë shumë e vogël, në punëtoritë që organizon Komuna përveq që mësoni prej OSBE-së mësoni edhe prej kolegeve prej tjerave Komuna.

Xhejlane Behluli tha: a nuk kanë marr pjesë në trajnime stafi i Komunës apo asambleistat?.

Edmond Hyseni tha: stafi i Komunës.

Mirjana Simijonovic tha: pajtohem me atë që e tha Edmondi se ju i keni ftu në puntori ata nuk vin pasi që mendojnë se po e kryejn punën më së miri.

Kryesusi tha: po pajtohem me Edmondin, ne do ta bëjm punën tonë ndërsa kshillit ekzekutiv i mbetet nese don të bashkpunoj apo jo me Kuvendin.

Pasi nuk pati proozime tjera aprovohet orari i mbjtjes së mbledhjeve të KPF-së.

Pika e pestë: Propozimi i orarit të mbajtjes së mbledhjeve të KK për vitin 2020;

Kryesuesi tha: e keni marr me material edhe orarin e mbajtjes se mbledhjeve të Kuvendit, mbledhjet si zakonisht do të mbahen në ora 10:00, nuk ka mbledhje ditëve të premte dhe vikendeve, nese keni ndonjë propozim.

Pasi nuk pati diskutime aprovohet njëzëri kjo pikë që të shkoj në Kuvend.

Kryesus tha: po pajtohem që ta bëjm edhe planin e punës andaj do të takohemi javen e ardhshme që ta bëjm planin e punës.

Kryesusi tha: a pajtohen që të hy në rend dites për Kuvend aporovimi i planit të punës së Kuvendit.

Aprovohet njëzëri që të hy në rend dites edhe ky propozim.

Pika e gjashtë: Pruarja e vendimit për shitjen e automjeteve të vjetëra dhe të zhvlersuara të Komunës së Novobërdës;

Për këtë pikë ja dha fjalen Driton Abdylit.

Driton Abdyli tha: unë propozoj që të mirret vendimi për këtë pikë nese votohet këtu dhe shkon në Kuvend, mundeni edhe të formoni një komision prej Kuvendit, e keni pasur këtë propozim edhe me herët që të shiten këto automjete përmes shtëpisë së ankandeve, ato vetura nuk i duhen më askujt.

Kryesusi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Xhejlane Behluli tha: e kam një pyetje, nese ato mjete shiten a do të investohet në automjete tjera apo si do të veprohet?. Po lidhem me këtë pikë pasi që kam bërë kërkesë në Drejtorinë e Financave përkatësishtë në departamentin e tatimit në pronë, pasi që ka shumë shtëpi të reja që janë ndertu në fshatin Pasjak dhe nuk dalin pothuajse që 2 vite që ti regjistrojn edhe pse është në interes të Komunës pasi që janë tatimpagues të Komunës tonë dhe këta zyrtarë janë arsyetu se nuk po kemi automjete që të dalim e ti regjistrojmë. E kemi parë se sa shumë po investohet po ndertohen villa por nese ato villa nuk regjistrohen nuk rriten as të hyrat për Komunën, unë jam për me përkrahë.

Mirjana Simijonovic tha: është hera e tretë që Drejtori po e propozon këtë qështje, nese e aprovojm kemi shumë automjete në gjithë tertorin e Komunës që kanë mbet të shiten të gjitha dhe nese shiten ato mjete ju kisha lut që të bleni një vetur më të mirë për Kryetarin pasi që është gjithë kohen në terren e po ka vështërsi, sa ju perket zyrtarve nuk kanë nevoj pasi që nuk dalin në terren, që e permendi Xhejlanja se po zhvillohet Komuna nuk e di se sa ka të hyra dhe sa ka interes Komuna prej atyre ndertimeve.

Milica Jovanovic tha: unë do ta përkrahi këtë piken e Drejtorit, ndërsa sa i perket asaj që e permendi Xhejlani se zyrtarët janë arsyetu se spo kanë vetur me dal në terren ta njoftoj Xhejlanin se problemi është se ata vin në ora 09:00 shkojn në ora 12:00 dhe skan kohë se kur të dalin.

Selatin Nuhiu tha: e dim se Drejtori e ka propozu këtë pikë dy herë për shtijen e këtyre veturave, e dim se këto vetura vetem po nxajnë vend në parking, mendoj se këto vetura duhet të shiten por që të jemi transparent të formohet një komision edhe prej Kuvendit Komunal. Të gjithë e dim se në Komunën tonë ka munges të automjeteve, si dhe zyra e Kuvendit duhet të ketë një veturë për të na dergu materialin e Kuvendit si dhe për punë tjera zyrtare, jam që kjo pikë të shkoj në Kuvend.

Xhejlane Behluli tha: qëllimi ynë është interesi i qytetarëve para ne të gjithëve dhe qytetarët uk kanë faj sa i perket problemeve tona legjislativ-ekzekutiv, ata që kanë kërku me i regjistru shtëpit nuk janë përkrahës të mij por qytetarë të fshatit Pasjak.

Mirjana Simijonovic tha: pajtohem me propozimin e Drejtorit që të shkoj në Kuvend dhe aty të formohet një komision por kam frik se edhe nese formohet komisioni nuk kemi me u pyt ne, gjithëmonë kur ka qenë interesi i qytetarëve kemi votuar për si për bartje të mjeteve, si për ndihmë qytetarëve për blerjen e kafshëve etj., por nuk e kemi ditur se çka ka ndodhur më pas.

Milica Jovanovic tha: pajtohem me propozimin e koleges edhe nese fomoni komision të mos jetë asnjë antarë i Kuvendit, pasi që të gjitha komisionit që janë formuar si për emrim të rrugëve si për mbyqyrje financiare ose mbyqyrje të ndonjë realizimi të projekti asnjëherë nuk na kanë ftu dhe asnjë informat nuk na është ofru. Pasi nuk pati diskutim tjera aprovohet njëzëri nga antarët prezent kjo pikë që të shkoj në Kuvend.


Pika e gjashtë: Të ndryshme.

Kryesuesi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Mirjana Simijonovic tha: e kam një vërejtje pasi që 4 vite nuk kemi nxemje as në mbledhje të KPF-së dhe as të Kuvendit.

Pasi nuk pati diskutime Kryesuesi i falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje.
Mbledhja përfundoi në orën 11:00.

Procesëmbajtëse
Valmire Mustafa



Kryesues i Kuvendit
Nebojsa Arsic

